

## **NJOFTIM PER SHTYP**

“Shoqata e Bursistave të DAAD-së” organizon në datat 4 dhe 5 Korrik 2011 Konferencën me temë “**Brain drain – Brain gain**”, një temë mjaft e rëndësishme për zhvillimet aktuale në vendin tonë. Janë të ftuar gjithë ish-bursistët e DAAD-së, drejtues të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të Instituteve të Arsimit të Lartë, të Ambasadës së RFGJ-së në Shqipëri, të Organizatave jo-fitimprurëse që operojnë në këtë fushë, etj..

Ne Konferencë do të paraqiten studime shkencore dhe referate nga përvoja e emigrimit të akademikëve jashtë vendit (Brain drain) si dhe problemet që lidhen direct me universitetet dhe tregun e punës në Shqipëri. Do të prezantohen strategjitë e mundshme për rikthimin në vend të akademikëve si dhe integrimin e tyre në strukturat e shoqërisë shqiptare. Do të tregohen mundësitë që ju ofrohen grupeve të interes si dhe do të shkëmbehen përvojat e derimëtanishme.

Gjithashtu në konferencë do të ketë dhe forum diskutimi rreth çështjeve praktike (aplikimi, ndryshimet interkulturore në filozofinë e sipërmarrjeve, komunikimi, pritshmëritë nga punëdhënësit dhe punëmarrësit) me përfaqësues të firmave gjermane që operojnë në Shqipëri.

Konferenca do të zhvillohet në ambjentet e godinës “Liria” (ish-Pallati i Kulturës i Qytetit Studenti). Ceremonia e hapjes fillon në ora 11.00 të datës 4 Korrik 2011.

Ajo financohet nga DAAD (Deutsche Akademische Ausstauschdienst – Shërbimi i Shkëmbimeve Akademike të Gjermanisë). DAAD është organizata më e madhe në Gjermani, përgjegjëse për menaxhimin e programeve, të cilat mbështesin bashkëpunimin dhe shkëmbimin në arsimin e lartë në të gjithë botën. Që prej 1994, DAAD-ja ka dhënë rreth 4000 bursa në kuadër të shkëmbimit akademik me Shqipërinë. Gjithashtu DAAD, gjatë kësaj periudhe, mbështet Institutet e Arsimit të Lartë në Shqipëri me 2 Profesorë të “Herder”, si dhe me 2 Lektorë dhe një Asistente për gjuhën. Edhe për vitin 2011 DAAD-ja do të japë bursa për studentë, doktorantë dhe kërkues shkencor.

Për kontaktë

[info@daad-al.org](mailto:info@daad-al.org)